



Prishtinë, 27 gusht 2020  
Kodi i ZRRE-së: V\_1273\_2020

#### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

#### Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtrithshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve, dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin në parcelën ngastrave kadastrave Nr. 00486-20, me kapacitet të instaluar prej **100 kW** në Komunën e Ferizajt, të datës 23.06.2020 nr. prot.258/20 të aplikuesit "GNTC GROUP" SH.A., me adresë: Rruga "Cen Durguti", Komuna Ferizajt, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur më 27 gusht 2020 nxori këtë:

### V E N D I M

#### PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. **APROVOHET** - kërkesa e aplikuesit "GNTC GROUP" SH.A., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike në objektin në parcelën ngastrave kadastrave Nr. 00486-20, sipas Pëlqimit nr. 04-016/01-0048957/20 i dt. 08.07.2020 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizmit dhe Mjedis, me kapacitet të instaluar prej **100 kW**, që do të vendosen mbi objekt në Komunën e Ferizajt.
- II. **OBLIGOHET** – aplikuesi "GNTC GROUP" SH.A., me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DFE-9021234 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtrij kërkesë në KEDS SH.A., për pranimit teknik të objektit energjetik.



III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.

IV. Aplikuesi "GNTC GROUP" SH.A., do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.

### Arsyetim

- ZRRE, me datë 23.06.2020 nga aplikuesi "GNTC GROUP" SH.A., ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike në objektin në parcelën ngastrave kadastrave Nr. 00486-20, sipas Pëlqimit nr. 04-016/01-0048957/20 i dt. 08.07.2020 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizmit dhe Mjedis, me kapacitet të instaluar prej **100 kW**, që do të vendosen mbi objekt në Komunën e Ferizajt.
  - Aplikuesi, s'bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluar, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 4402 të datës 19.06.2020 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Pëlqimin nr. 04-016/01-0048957/20 i dt. 08.07.2020 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Ferizajt.
  - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit "GNTC GROUP" SH.A., dhe dëshmime të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në objektin në parcelën ngastrave kadastrave Nr. 00486-20, me kapacitet të instaluar prej **100 kW**, në Komunën e Ferizajt, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

